



UNIVERSITETI-UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Nr. Prot.

71

Dt. Pranimit

02.09.2025

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"

" Zija Shemsu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

FORMULARI I VLERËSIMIT F2

Fakulteti	Fakulteti i Edukimit
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	<i>Letërsi për fëmijë (Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor); Edukimi dhe mediat (Arsimi Parashkollor); Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla (Arsimi Parashkollor); Letërsi popullore (Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); Tipologji e letërsisë shqipe (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe)</i>
Thirrja për të cilën konkurron kandidati	Profesor i rregullt
Kandidatët e paraqitur:	1. Prof. Asoc. Dr. Nevrije Ismaili 2. Dr. sc. Fatbardha Nuhiu-Sadriu

Sqarim nga Komisioni vlerësues:

Komisioni vlerësues është bazuar në konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Ref. nr. 01/2382 Dt. 05/08/2025, ku në pikën 2. të konkursit nga Fakulteti i Edukimit (avancime ose riemërime) kërkohet një (1) mësimdhënës për lëndët *Letërsi për fëmijë (Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor); Edukimi dhe mediat (Arsimi Parashkollor); Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla (Arsimi Parashkollor); Letërsi popullore (Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); Tipologji e letërsisë shqipe (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe)*.

Komisionit i ka arritur aplikacioni i kandidates Nevrije Ismaili, brenda afatit të përcaktuar kohor në konkurs. Aplikacioni i kandidates është trajtuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Po kështu komisionit i ka arritur edhe një aplikacion nga nja kandidate e sipas konkursit nuk i plotëson kushtet formalo-juridike, në radhë të parë sipas nenit 2, paragrafi 2, pika 2.1 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/1328/dt. 26/06/2024. Prandaj në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të njëjtën nuk është hartuar fare raporti.

Komisioni, ka shqyrtuar aplikacionin, përkatësisht gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kandidatja, vlerësimin për të cilën, duke u bazuar në Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/1328/dt. 26/06/2024, e paraqet në këtë formular.

Komisioni vlerësues:

1. Prof. Dr. Osman Gashi, kryetar
2. Prof. Dr. Sali Bashota, anëtar
3. Prof. Dr. Zeqir Kadriu, anëtar

I. TË DHËNAT PËR KANDIDATIN

Emri dhe mbiemri: NEVRIJE ISMAILI

Tabela 1. Të dhënat për kandidatin /ët për të cilin shkruhet raporti/et

Emri dhe mbiemri	Nevrije Ismaili
Ditëlindja dhe vendlindja	15.11.1969, Tabanovc, Maqedoni e Veriut
Grada shkencore dhe viti kur është fituar	Doktor i shkencave filologjike
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje)	Profesor i asociuar (Prof. Asoc)
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	2020
Universiteti/fakulteti/departamenti ku është fituar titulli akademik	Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan Fakulteti i Edukimit
Arsimimi i lartë	
STUDIMET THEMELORE	
Institucioni	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Filologjisë
Vendi	Prishtinë
Titulli i fituar	Profesor
Data / viti i diplomimit	5.12.1997
Fusha e studimit	Letërsi dhe gjuhë shqipe
STUDIMET MASTER / MAGJISTRATURË	
Institucioni	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Filologjisë
Vendi	Prishtinë
Titulli i fituar	Magjistër i Shkencave Filologjike
Data / viti i diplomimit	26.5.2006
Fusha e studimit	Letërsi dhe gjuhë shqipe
STUDIMET E DOKTORATËS	
Institucioni	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Filologjisë
Vendi	Prishtinë
Titulli i fituar	Doktor i shkencave filologjike

Tabela 2. Të dhënat lidhur me gradën e fituar shkencore

Grada shkencore	Doktor i shkencave filologjike
Thirrja e fituar akademike	Profesor i asociuar
Viti kur është fituar thirrja aktuale (vlen për rizgjedhje)	2020
Vendimi Ref.nr	01/1164 Dt. 21/09/2020
Universiteti / Fakulteti / Departamenti	Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan Fakulteti i Edukimit
Nostrifikimi / MASHT/ NARIC	//

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 2

Kandidatja Nevrije Ismaili është doktore e shkencave të filologjisë, ndërkaq ka thirrjen akademike profesor i asociuar, nga viti 2020.

Aktualisht është mësimdhënëse e lëndëve nga fusha e letërsisë, në Fakultetin e Edukimit në UKZ.

Prandaj, sa i përket kësaj pike kandidatja Nevrije Ismaili i plotëson kushtet, sipas nenit 170, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika 2.1 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan dhe të nenit 5, paragrafi 2, pika 2.1 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024

Tabela 3. Monografitë

Nr.	Autori/ët	Titulli i publikimit	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti
1.	Nevrije Bislmi - Ismaili	Anton Çetta mbledhës dhe studiues i folklorit	Letërsi	Enver Mehmeti Liman Matoshi	“Rozafa”, Prishtinë, 2008. 987-9951-02-150-0
2.	Nevrije Bislmi - Ismaili	Poetika e këngës epike historike	Letërsi	Enver Mehmeti Sali Bashota Liman Matoshi	“Embata”, Prishtinë, 2018. 978-9951-424-71-4

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 3

Kandidatja Nevrije Ismaili ka të botuara dy monografi. Monografia “Anton Çetta mbledhës dhe studiues i folklorit” është një libër i cili pasqyron në mënyrë të përmbledhur veprimtarinë shkencore të njërit prej mbledhësve dhe studiuesve më të shquar të folklorit shqiptar.

Ndërkaq monografia “Poetika e këngës epike historike” është një studim i gjerë mbi poetikën e këngës epike historike. Në këtë monografi pothuajse në mënyrë shteruese është pasqyruar poetika e kësaj pjese të letërsisë gojore shqiptare.

Duke u bazuar në nenin 170, paragrafi 2, pika 2.3 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan dhe të nenit 5, paragrafi 2, pika 2.3 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024, kandidatja Nevrije Bislmi i plotëson këtë kusht formalo-juridik.

Tabela 4. Tekstet mësimore

Nr.	Autori/ët	Titulli i publikimit	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti
1.	Nevrije Ismaili	Letërsi popullore	Letërsi	Merxhan Avdyli Flamur Maloku	Agamenoni, Prishtinë, 2024. ISBN 978-9951-839-71

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 4

Kandidatja Nevrije Ismaili ka paraqitur tekstin universitar “Letërsi popullor”, me të cilin plotëson kushtin formalo juridik sipas nenit 170, paragrafi 2, pika 2.4 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan dhe të nenit 5, paragrafi 2, pika 2.4 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

Tabela 5. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT nr. 01/2018 dhe nenit 5, pika 2.5 dhe nenit 10, pika 4 të Rregullores, 01/1328 dt. 26/06/2024, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1	Nevrije Ismaili Nerxhivane Krasniqi	<i>Open access</i> An ethnomusical analysis: Albanian highland songs Ismaili, N., Krasniqi, N.	<i>Rast Muzikoloji Dergisi</i> This link is disabled.,	Vëll. 10(2), pp. 257–271 2022	Rast Muzikoloji Dergisi » Cilt: 10 Sayı: 2
2	Nevrije Ismaili Mensur Neziri	<i>Albanian Songs of The Battle of Fushë Kosovë (1389)</i> Ismaili, N., Neziri, M.	<i>International Journal of Religion</i> This link is disabled.,	Vëll., 5(10), pp. 693–705 2024	Vol. 5 No. 10 (2024) International Journal of Religion
3	Nevrije Ismaili Mensur Neziri	Folklore In Elementary School Textbooks Ismaili, N., Neziri, M.	<i>International Journal of Religion</i> This link is disabled	Vëll.5(10): Pp.4405-4414 2024	International Journal of Religion DOI: 10.61707/g2zqt557
4	Nevrije Ismaili Mensur Neziri	Project-based learning and development of learning competencies	Journal of Curriculum Studies Research		Është në proces
5.	Teuta Agaj Nevrije	English Manner Adjuncts in Anna Karenina and Their Correspondents in Albanian: A Structural Analysis	Journal of language teaching and research	Volume 16 Number 3, pp. 726-734 May 2025	https://doi.org/10.17507/jltr.16.3.03 DOI: 10.17507/jltr.1603.03 SCOPUS

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 5

Kandidatja Nevrije Ismaili ka paraqitur 5 punime, të cilat janë të indeksuara në revistat me impakt faktor, 2 prej të cilëve në platformën Scopus, që kërkohet edhe nga udhëzimi i MASHTI-t. Ndërkaq e ka paraqitur edhe një punim tjetër, i cili ende nuk është botuar, por që është në proces.

Kandidatja Nevrije Ismaili i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 170, paragrafi 2, pika 2.5 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan dhe të nenit 5, paragrafi 2, pika 2.5 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

Tabela 6. Punimet e publikuara në revista rajonale (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, B e H)

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Nevrije Ismaili	Modeli arbëresh i këngëve historike Vlerat dhe rëndësia e këngëve historike arbëreshe	“Filologjia”, Revistë shkencore ndërkombëtare për gjuhësi, letërsi dhe kulturë	Viti I.Nr.1.Prill ,f.195-2032013.	Universiteti Shtetëror i Tetovës
2.	Nevrije Ismaili	Këngët për Luftën e Kosovës (1389)	Kultura popullore	Viti XXXIV 71-72,nr.1-2/2015,f.169-195	Tiranë,2017. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit te Artit
3.	Nevrije Ismaili	Lindja dhe ritet e saj në rajonin e Gjilanit”	Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup ©ITSHKSH	2021	<u>AGJENDA E KONFERENCËS SHKENCORE KUSHTUAR RITEVE TË CIKLIT JETËSOR – ITSH</u>
4.	Nevrije Ismaili	BALADA E MURIMIT DHE POPUJT E BALLKANIT	<u>3.- Ballkanologji-3.pdf</u> ISBN: 978-608-4897-45-3 www.itsh.edu.mk	Vëll.3- Ballanologji-3 fq.292-298 2022	<u>3.-Ballkanologji-3.pdf</u>
5.	Nevrije Ismaili	KËNGËT E DASHURISË NË FSHATRAT TOSKE TË STRUGËS	ETNOALB Revistë shkencore për folklor dhe etnologji, Shkup ISSN 2545-4617	ETNOALB, viti IV, nr. 4 , f. 143-147 Shkup, 2020	ETNOALB, viti IV, nr. 4
6.	Nevrije Ismaili	Tyrbja e Roganës	Shoqata për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturore e Luginës së Preshevës	Libri 2021	Shoqata për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturore e Luginës së Preshevës
7.	Nevrije Ismaili	Figura e Anton Çettës	Shoqata për	Libri 2024	Shoqata për

		dhe ndihmesat e tij në albanologji	Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturore e Luginës së Preshevës		Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturore e Luginës së Preshevës
--	--	------------------------------------	--	--	--

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 6

Kandidatja në këtë pjesë ka paraqitur 7 punime të saj nga fusha e studimit të letërsisë, në veçanti të letërsisë gojore shqiptare. Po kështu duhet theksuar se 5 punime të paraqitura këtu janë të publikuara pas fitimit të thirrjes së dytë, përkatësisht pas marrjes së thirrjes akademike profesor i asociuar dhe janë në përputhje me udhëzimet e MASHTI-t për avancimin e mësimdhënësve nga fusha e studimeve të albanologjisë.

Kandidatja Nevrije Ismaili i ka 7 punime nga fusha e studimit të letërsisë, të cilat si të tilla janë edhe një mbështetje tjetër për avancimin e tij, sipas UA – MASHT nr. 01/2018, neni 3, paragrafi 6.

Tabela 7. Punimet e publikuara në revista kosovare

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Nevrije Ismaili Liridona Mehmeti	Rëndësia e Këngëve historike arbëreshe për figurën e Skënderbeut	ACADEMIASHTUBLLAE, Revistë Shkencore KDU:008(-18)(05) (496.51) 82-94.09(05)	Vëllimi IV, nr.1, fq.107-114 (7), 2022	Academiastubllagj@hotmail.com
2.	Nevrije Ismaili	Kosova në këngët historike	Seminari Ndërkombëtarë për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare	Seminari XXVII Ndërkombëtarë për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2008, f.423-430.	Universiteti i Prishtinës
3.	Nevrije Ismaili	Elementet artistike të këngëve majekrahu	Seminari Ndërkombëtarë për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare	Seminari XXXIX Ndërkombëtarë për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 2020	Universiteti i Prishtinës

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 7

Kandidatja në këtë pjesë ka paraqitur 3 punime të saj nga fusha e studimit të letërsisë, sidomos nga fusha e studimit të folkloristikës shqiptare.

Punimet e paraqitura këtu janë në përputhje me udhëzimet e MASHTI-t për avancimin e mësimdhënësve nga fusha e studimeve albanologjike. sipas UA – MASHT nr. 01/2018, neni 3, paragrafi 6.

Tabela 8 . Prezantimet në konferenca

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi etj.	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku
1.	Nerxhivane Krasniqi Nevrije Ismaili	The influence of the family on child's development	Konferenca UKZ 2023	UKZ Annual Conference 2023 (Libri i abstrakteve)	
2.	Nevrije Ismaili Rina Rasimi	Folklori ne tekstet shkollore (nga kl.1-5)	Konferenca UKZ 2024	UKZ Conference 2024 (Libri i abstrakteve)	
3.	Nevrije Ismaili Rina Rasimi	Funksion edukativ i përrallave popullore në epokën e teknologjisë dhe mediave	Konferenca UKZ 2025	UKZ Conference 2025	

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 8

Kandidatja në këtë pjesë ka paraqitur pjesëmarrjen e saj në 3 konferenca shkencore tejet të rëndësishme, nga fusha e studimit të letërsisë, në të cilat është paraqitur me kumtesa.

Tabela 9. Kontribute të tjera shkencore dhe profesionale

Nr.	Autoret (renditja si ne kontributin shkencor)	Lloji i kontributit shkencor	Vendi, Viti
1.	Nevrije Ismaili	Anëtare e Këshillit për organizim të Konferencës në UKZ	2023
2.	Nevrije Ismaili	Anëtare e Këshillit për organizim të Konferencës në UKZ	2024
3.	Nevrije Ismaili	Anëtare e Këshillit për organizim të Konferencës në UKZ	2024
4.	Nevrije Ismaili	Anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, 2015-2018.	2018
5.	Nevrije Ismaili	Anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, 2018-2021	2021
6.	Nevrije Ismaili	Kryetare e jurisë profesionale për Çmimin Kombëtar Letrar "Azem Shkreli" 2018, e emëruar nga MKRS.	2018
7.	Nevrije Ismaili	Anëtare e jurisë profesionale për vlerësimin e poezive në edicionin e 38-të të festivalit "takimet e poeteshave shqiptare", në Vushtrri	2022

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 9

Kandidatja Nevrije Ismaili ka edhe kontribute të tjera shkencore dhe profesionale, të cilat i ka paraqitur në tabelën e mësipërme. Prandaj, kandidatja e plotëson edhe këtë kusht sipas nenit 170, paragrafi 2, pika 2.9 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan dhe të nenit 5, paragrafi 2, pika 2.9 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024

Tabela 10. Përvoja në mësimdhënie universitare

Periudha e angazhimit (vitet akademike)	Grada shkencore dhe Thirrja akademike	Institucioni, Vendi	Programi i studimit	Ligjërues i lëndëve	Vërejtje
2003	Magjistër	Fakulteti i Filologjisë	Letërsi dhe Gjuhë Shqipe	Letërsi popullore; Letërsi për fëmijë; Eposi i kreshnikeve	
2010-2016 2016-2020	Dr. Sc.	Fakulteti i Filologjisë (UP; Fakulteti i Edukimit (UKZ)	Letërsi dhe Gjuhë Shqipe Fakulteti i Edukimit	Letërsi për fëmijë; Etnologji dhe letërsi popullore; Dramatizmi dhe shfaqjet me kukulla; Edukimi dhe mediat; Shkrim akademik	

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 10

Kandidatja Nevrije Ismaili ka një përvojë të mirë në arsimin e lartë. Ajo ka qenë një kohë asistente e angazhuar në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, pastaj edhe ligjëruese në po këtë universitet, përkatësisht në Fakultetin e Filologjisë, si dhe Fakultetin e Edukimit. Ndërkaq, aktualisht është mësimdhënëse në UKZ, në Fakultetin e Edukimit, me thirrjen profesor asistent.

Kandidatja Nevrije Ismaili i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 170, paragrafi 2, pika 2.8 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan dhe të nenit 5, paragrafi 2, pika 2.8 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024

Tabela 11. Udhëheqje të temave master dhe të doktoratës

Periudha e mentorimit	Institucioni Vendi	Mentorime në studimet Master	Mentorime në studimet e doktoratës	Vërejtje
2024	UKZ	Abetare Mehmeti: “Poezia atdhetare e Naim Frashërit dhe perceptimi i nxënësve për të”		Është mbrojtur
2024	UKZ	Arbenitë Murtezi: “Satira dhe kritika sociale në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” të Dritëro Agollit”		Është mbrojtur
2024	UKZ	Albulena Abdullahu: “Vepra poetike e Merxhan Avdyllit”		Është mbrojtur
2024	UKZ	Flutura Tahiri: “Letërsia e vjetër shqipe në tekstet letrare të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta”		Është mbrojtur
2024	UKZ	Leutresa Rahmani: “Figura e Skënderbeut në tekstet letrare të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta”		Është mbrojtur
2024	UKZ	Besjana Zymeri: “Ndikimi i letërsisë		Është

		shqipe në zhvillimin e aftësive komunikuese të nxënësve të shkollës së mesme të ulët (6-9)"		mbrojtur
2024	UKZ	Arbnora Mehmeti: "Veprimet kanunore të personazheve në romanet "Prilli i thyer" i Ismail Kadaresë dhe "Gjarpinjtë e gjakut" i Adem Demaçit"		Është mbrojtur
2024	UKZ	Lirije Gashi: "Poezia e Gjergj Fishtës në librat shkollore të ciklit të mesëm të ulët dhe të lartë"		Është mbrojtur
2024	UKZ	Makfire Musa: "Krijimtaria letrare e Avdush Canajt"		Është mbrojtur
2024	UKZ	Blerta Korçaj: "Letërsia e vjetër shqipe dhe Letërsia romantike-niveli krahasues në tekstet shkollore në shkollat e mesme të ulëta"		Është mbrojtur
2024	UKZ	Rilinda Lenjani-Kastrati: "Letërsia Arbëreshe në tekstet shkollore të arsimit të mesëm të ulët"		Është mbrojtur

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 11

Kandidatja Nevrije Ismaili deri tash ka mentoruar disa studentë, të cilët tashmë kanë përfunduar studimet master, ndërsa disa të tjerë janë në procesin e mbrojtjes së temës së diplomës.

Kandidatja Neverije Ismaili i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 170, paragrafi 2, pika 2.2 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe të nenit 5, paragrafi 2, pika 2.2 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

Tabela 12. Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

Nr.	Programi/ projektishkencor	Periudha kohore	Institucioni, Vendi	Pozita ne program, projekt/ Kontribut
1.	Projekti TAKE-i Caritasit	2023-2025	Universiteti "Kadri Zeka" Gjiilan	Koordinatorë
2.	SPSS Training	2021	Businesses Development Group	Pjesëmarrëse
3.	Hulumtimi dhe publikimet shkencore	2022	Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë	Pjesëmarrëse
4.	Metodat e avancuara të mësimdhënies	2022	Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë	Pjesëmarrëse
5.	Hartimi i planit zhvillimor individual	2021	Universiteti "Kadri Zeka" Gjiilan	Pjesëmarrëse
6.	Të mësuarit përmes lojës, rezultatet didaktike dhe kreativiteti	2021	Projekti SHPRESE, CARITAS	Pjesëmarrës

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 12

Kandidatja Nevrije Ismaili ka marrë pjesë në 6 projekte, qoftë në formë punëtorie, qoftë në formë të trajnimit. Prandaj ajo i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 170, paragrafi 2, pika 2.7 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan dhe të nenit 5, paragrafi 2, pika 2.7 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

II. KANDIDATËT TË CILËT NUK I KANË PLOTËSUAR KUSHTET FORMALO – JURIDIKE

Kandidati nr. 2. Fatbardha Nuhio-Sadriu

Kandidatja **Dr. Sc. Fatbardha Nuhio-Sadriu** nuk i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas konkursit për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit “Kadri Zeka” Gjiilan, Ref. nr. 01/2382 Dt. 05/08/2025, ku në pikën 3. të konkursit nga Fakulteti i Edukimit (avancime ose riemërim) kërkohet një (1) mësimdhënës për lëndët *Letërsi për fëmijë (Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor); Edukimi dhe mediat (Arsimi Parashkollor); Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla (Arsimi Parashkollor); Letërsi popullore (Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); Tipologji e letërsisë shqipe (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe).*

Po kështu kandidatja **Dr. Sc. Fatbardha Nuhio-Sadriu** nuk i plotëson kushtet formalo-juridike sipas nenit 2, paragrafi 2, pika 2.1 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/1328/dt. 26/06/2024.

Prandaj në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të njëjtën nuk është hartuar fare raporti.

III. PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

THIRRJA AKADEMIKE E CILA PROPOZOHE: **Profesor i rregull (Prof. Dr.)**

Komisioni vlerësues, i formuar me vendimin e Këshillit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan (Ref.nr. 489, dt. 12.08.2024), duke u bazuar në nenin 170 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjiilan, Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024 dhe konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit “Kadri Zeka” Gjiilan, Ref. nr. 01/2382 Dt. 05/08/2025, pas shqyrtimit të dosjes së kandidatës së vetme që është paraqitur në konkurs, për pozitën një mësimdhënës për lëndët *Letërsi për fëmijë (Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor); Edukimi dhe mediat (Arsimi Parashkollor); Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla (Arsimi Parashkollor); Letërsi popullore (Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); Tipologji e letërsisë shqipe (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe).*

PROPOZON

Prof. Asoc. Dr. Nevrije Ismaili për thirrjen akademike **Profesor i rregullt (Prof. Dr.)** në Fakultetin e Edukimit, pranë Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan.

ARSYETIM


Duke u bazuar në nenin 170 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan; nenin 5, Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. dhe konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Ref. nr. 01/2382 Dt. 05/08/2025, si dhe në dokumentacionin e kandidates, Komisioni vlerësues, njëzëri propozon që kandidatja Prof. Asoc. Dr. Nevrije Ismaili të zgjedhet në thirrjen **Profesor i rregullt (Prof. Dr.)** për lëndët *Letërsi për fëmijë (Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor); Edukimi dhe mediat (Arsimi Parashkollor); Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla (Arsimi Parashkollor); Letërsi popullore (Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); Tipologji e letërsisë shqipe (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe).*

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

Prof. Dr. Osman Gashi, kryetar

Prof. Dr. Sali Bashota anëtar

Prof. Dr. Zeqir Kadriu, anëtar



Gjilan, më 29 gusht 2025